

ÉVALUATION DIAGNOSTIQUE
DES ÉLÈVES ALLOPHONES

Compréhension de l'écrit

CYCLE 4 FIN DE 3E

Langue d'origine : albanais

MBIEMRI:

EMRI:

NIVEAU : FIN DE 3^e**LEXONI TEKSTIN E MËPOSHTËM:**

Ajo ishte nata më e bukur; hëna po perëndonte dhe yjet po shkëlqenin me një ndriçim më të gjallë në kaltërsinë e thellë të qiellit. Pemët nuk i lëvizte asnjë shkulum ere; ajri ishte i ngrohtë dhe erëmirë.

Ajo ishte mbështetur mbi bërryl, me sytë drejt qiellit; unë isha përkulur pranë saj, dhe e vështroja teksa ëndërronte.

Pas pak, edhe unë i ngrita sytë lart; një ndjesi melankolike na dehte të dyve. Ne thithnim së bashku shtjellat e ajrit të ngrohtë që dilnin nga kaçubet; në horizontin e largët, ndiqnim rrëzëllimat e fundit me një bardhësi të zbehtë, të cilat hëna i tërhiqte me vete teksa kridhej pas siluetave të zeza të gështenjave. Më erdhi ndërmend një tjetër ditë kur kisha vështruar me dëshpërim zbrazëtinë e gjerë të këtij qielli të bukur. Ky kujtim më rrëqethi; tani gjithçka ishte kaq plot! [...]

Hodha krahun rreth belit të së dashurës sime ; ajo ktheu kokën ngadalë; sytë e saj ishin mbushur me lot. Trupi i saj u përkul si fije bari, buzët gjysmë të hapura prekën të miat dhe gjithësia u harrua krejt.

Alfred de Musset, *Rrëfimi i një fëmije të këtij shekulli*, 1836.

RRETHONI PËRGJIGJEN APO PËRGJIGJET E SAKTA

1

Sa personazhe ka teksti?

- 1
- 2
- 3

MI

MF

MS

TBM

2

Ku dhe kur zhvillohet ngjarja?

- Në një apartament
- Në agim
- Jashtë
- Në mbrëmje

MI

MF

MS

TBM

3

Ky fragment tregon:

- Një takim mes miqsh
- Një njohje të re
- Një takim dashurie
- Një ndarje
- Një ëndërr

MI

MF

MS

TBM

4

Mjedisi është:

- shqetësues
- romantik
- i zymtë
- paqësor
- nuk dihet

MI

MF

MS

TBM

5

Renditni elementet sipas rendit kronologjik duke vendosur numrat nga 1 në 4:

..... Personazhet puthen.

..... Personazhet vështrojnë peizazhin.

..... Vajza qan.

..... Narratori rikujton një ngjarje të dhimbshme.

MI

MF

MS

TBM

6

Lidhni me vijë fjalët në të majtë me antonimet e tyre në të djathtë:

- Erëmirë •
- Sensualitet •
- Melankolik •
- Nostalgjik
- I parfumosur
- Kënaqësi
- Pa aromë
- Neveri
- I gëzuar

MI

MF

MS

TBM

7

Përse po qan vajza sipas jush?

[Rretho përgjigjen apo përgjigjet e sakta duke u mbështetur te teksti]

- Asaj i vjen inat që po e lejon veten të joshet nga narratori
- Ajo është e trembur
- Ajo është e lumtur
- Ajo është e sëmurë

MI

MF

MS

TBM

8

Cilat janë efektet e dashurisë te narratori ? [Rrethoni përgjigjen e saktë]

Dashuria e bën të harrojë pjesën tjetër të botës.

• E VËRTETË

• E GABUAR

• NUK DIHET

E bën të ndihet i trishtuar.

• E VËRTETË

• E GABUAR

• NUK DIHET

I ndryshon perceptimin e tij për botën.

• E VËRTETË

• E GABUAR

• NUK DIHET

I jep kuptim ekzistencës së tij.

• E VËRTETË

• E GABUAR

• NUK DIHET

MI

MF

MS

TBM

Rappel des codes de correction :

MI = maîtrise insuffisante MF = maîtrise fragile MS = maîtrise satisfaisante TBM = très bonne maîtrise

MI et MF : non acquis MS et TBM : on considère que c'est acquis